



Институт за човекови права

RËNDËSIA E QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT PËR T'IU PËRGJIGJUR KRIZËS SHËNDETËSORE KOVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



USAID
ОД АМЕРИКАНСКИОТ НАРОД

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Titulli:

RËNDËSIA E QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT PËR T'IU PËRGJIGJUR KRIZËS SHËNDETËSORE KOVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Botues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Për botuesin:

Margarita Tsatsa Nikollovska

Redaktore:

Vesna Stefanovska, PhD

Autor:

Martina Smilevska Kcheva

Përktheu:

Blerina Starova Zllatku

Dizajni grafik:

Damjan Kanzurov

Shkup, marsi 2022

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara, USAID-it apo Qeverisë së SHBA-së.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
1. Pse është e nevojshme të zbatohet një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut në politikëbërjen publike gjatë përgjigjes ndaj Kovid-19?	7
2. Pasqyrë e përgjigjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj krizës shëndetësore të shkaktuar nga KOVID-19 dhe ndikimi i saj te qytetarët	13
2.1. Konteksti politik në periudhën e shfaqjes së Kovid-19 në RMV	13
2.2. Gjendja e jashtëzakonshme dhe sundimi i së drejtës.....	13
2.3. Ndalimi dhe kufizimi i lëvizjes.....	15
2.4. Shëndeti Publik	19
2.5. Arsimi.....	23
2.6. Masat ekonomike për rimëkëmbje	24
3. Përfundime.....	27
4. Rekomandime	28

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pandemia Kovid-19, e cila tashmë po hyn në vitin e tretë, ka goditur rëndë qytetarët, bizneset dhe gjithë sistemin shoqëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qeveria e Republikës së Maqedonisë ndërmoi një sërë masash dhe strategjish për mbrojtjen e popullatës, të cilat kryesisht ishin të domosdoshme dhe proporcionale, por megjithatë në mënyrë të ndryshme ndikonin palët e përfshira. Pavarësisht përfshirjes së përgjigjes së shtetit, realiteti është se gjatë politikëbërjes dhe vendimmarrjes nuk janë marrë parasysh kushtet specifike në të cilat janë ndodhur qytetarët e cenuar, si personat me aftësi të kufizuara, romët, të moshuarit, personat me të ardhura të ulëta, fëmijët, viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, punëtorët seksualë dhe kërkuesit e azilit. Andaj, zbatimi i parimit, bazuar në të drejtat e njeriut gjatë sjelljes dhe zbatimit të politikave, masave dhe programeve është mënyra e vetme që mund të ndihmojë jo vetëm në mbrojtjen e shëndetit publik, por edhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të kategorive veçanërisht të cenueshme. Në kohë krize, QBDNJ i ofron shtetit një mjet të pazëvendësueshëm dhe të sigurt, përmes të cilit shteti do të garantojë që askush të mos përjashtohet dhe parimet që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për mirëqenien njerëzore të integrohen në një përgjigje më të drejtë, më realiste dhe më të qëndrueshme, të menjëhershme ose afatgjatë ndaj pandemisë.

HYRJE

Pandemia e shkaktuar nga KOVID-19 shkaktoi krizë shëndetësore, ekonomike dhe sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Si përgjigje, qeveria ka marrë një sërë masash kufizuese për të parandaluar ekspozimin e njerëzve ndaj virusit dhe ngadalësimin e përhapjes së tij, si dhe një sërë masash të tjera për të zbutur efektet negative të kufizimeve të vendosura. Masat e marra kanë ndikuar mjaft në kufizimin e të drejtave të qytetarëve, duke përfshirë vendosjen e orës policore, ruajtjen e distancës sociale, kufizimin e lëvizjes dhe grumbullimit, mbylljen e kufijve dhe ndalimin e trafikut ajror, edukimin online, ndalimin e ngjarjeve fetare dhe garave sportive, shtyrjen e afateve procedurale në proceset gjyqësore, mbylljen e bizneseve jothelbësore etj. Ndërkohë që kufizimet e tilla mbi liritë dhe të drejtat mund të kenë qenë pjesërisht të nevojshme për të kontrolluar pandeminë, shumë prej këtyre politikave kanë qenë shumë të gjera apo është neglizhuar ndikimi i tyre mbi kategoritë më të cënueshme të qytetarëve të cilët u rënduan jo vetëm nga virusit, por edhe nga pasojat socio-ekonomike.

Andaj, qëllimi i këtij dokumenti për politikat publike është të analizojë përgjigjen e Qeverisë së RMV-së (strategjitë, vendimet dhe aksesi i plotë në institucione) ndaj krizës shëndetësore, si dhe pasojat e saj për qytetarët e marginalizuar, dhe në këtë mënyrë të tregojë se pse parimi i bazuar në të drejtat e njeriut është zgjidhja më efektive për krijimin e politikave publike gjithëpërfshirëse, veçanërisht në kohë krize. Kjo analizë i referohet periudhës 2020 dhe 2021 dhe gjithashtu, do të japë konkluzione dhe rekomandime, me qëllim përmirësimin e masave të qeverisë në të ardhmen, ndërsa kufizimet të ofrojnë një bazë të mirë për respektimin e të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve, veçanërisht të grupeve të cënueshme.

Kuadri metodologjik i këtij dokumenti përfshin analizën e dokumenteve dhe një metodë të fokus grupeve të strukturuar. Analiza e dokumenteve bazohet në mbledhjen dhe analizën e burimeve primare dhe sekondare të të dhënave. Burimet primare të të dhënave përfshijnë masat, strategjitë dhe vendimet e miratuara të Qeverisë së RMV-së, si dhe dokumentet dhe të dhënat në dispozicion në lidhje me zbatimin e dekreteve dhe funksionalitetin e masave për uljen e pasojave të virusit. Burimet sekondare të të dhënave përfshijnë analiza, raporte dhe dokumente të përgatitura nga institucionet relevante vendore dhe ndërkom-bëtare, punime akademike, raporte dhe analiza të përgatitura nga organizata relevante qytetare të RMV-së, si dhe burime mediatike. Gjithashtu, për të përcaktuar ndikimin e masave në disa komunitete të marginalizuara, në vitin 2021 janë realizuar dy fokus grupe të strukturuar, me gjithsej 30 pjesëmarrës – përfaqësues të 21 organizatave qytetare. Qëllimi i fokus grupeve ishte, që përmes përvojave,

shembujve dhe diskutimeve, organizatat qytetare (OQ) të përcjellin pikëpamjet e tyre për zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në vendin tonë, në kushtet e një pandemie globale. Fokus grupet diskutuan sfidat dhe problemet e konstatuara gjatë zbatimit të masave të qeverisë, ndikimin e tyre mbi kategoritë e cënueshme të qytetarëve, si dhe shembuj të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe procedurave diskriminuese.

Kapitulli i parë, me titull: *Pse është e nevojshme të zbatohet Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në politikëbërjen publike gjatë përgjigjes ndaj Kovid-19?* përmban një shpjegim se përse një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut është alternativa më e mirë e mundshme në krijimin e politikave publike, veçanërisht në kohë pandemie. Kapitulli i dytë, me titull: *Pasqyrë e përgjigjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj krizës shëndetësore të shkaktuar nga KOVID-19 dhe ndikimit të saj te qytetarët* përmban shpjegimin e problemit dhe situatës aktuale, të strukturuar përmes ndikimit të përgjigjes së qeverisë mbi disa të drejta të caktuara të qytetarëve. Kapitulli i tretë përmban konkluzionet, ndërsa i katërti rekomandimet për institucionet shtetërore. Kjo strukturë synon të theksojë rëndësinë e kësaj qasjeje, të bazuar në të drejtat e njeriut, si dhe t'i mundësojë lexuesit të “perceptojë/lexojë” situatën (problemin) aktual përmes prizmit të saj.

1.

PSE ËSHTË E NEVOJSHME TË ZBATOHET NJË QASJE E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT NË POLITIKËBËRJEN PUBLIKE GJATË PËRGGJIGJES NDAJ KOVID-19?

Mbrojtja e shëndetit publik mund të ketë implikime mbi të drejtat e njeriut, si e drejta për lirinë e lëvizjes dhe shoqërimin, arsimin, për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim etj. Pandemia ka treguar se kur bëhet fjalë për vendimmarrje në luftën kundër koronavirusit, *të drejtat e njeriut shpesh herë gjenden në të dyja anët e ekuacionit, më së shumti si një dilemë midis mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së gjithë popullsisë (në një anë), dhe (...) ndërhyrjes së panevojshme në ushtrimin e lirive dhe të drejtave, siç janë liria e lëvizjes ose liria e shoqërimin¹* (në anën tjetër). Situata e imponuar nga kriza shëndetësore kërkonte në mënyrë të pashmangshme që shteti të marrë vendime urgjente për të parandaluar përhapjen e virusit, por kjo nuk duhet të nënkuptojë se të drejtat e njeriut duhen neglizhuar dhe konsideruar pasi të jenë marrë vendimet. Përkundrazi, në kohë krize, janë të domosdoshme *më shumë të drejta të njeriut, më shumë argumente për të drejtat e njeriut, më shumë vlerësime për të drejtat e njeriut dhe akoma më tepër drejtësi²*. Andaj, të drejtat e njeriut duhet të përfshihen në axhendën publike kur shqyrtohet çdo politikë dhe masë, si korniza kryesore organizative në formën e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut të zbatuar në vazhdimësi.

Por si duhet të jetë më saktë një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut?

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) e përkufizon QBDNj-në si *një kornizë konceptuale në procesin e zhvillimit njerëzor, e cila normativisht bazohet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe synon në mënyrë operative promovimin dhe mbrojtjen e tyre³*. Edhe pse në thelb është një ide e hershme, me qëllim integrimin e të drejtave të njeriut në programet zhvillimore, QBDNj për herë të parë merr një fushëveprimi të përcaktuar qartë në dokumentin e OKB-së, të titulluar Statement of Common Understanding⁴.

1 EUI Working Papers, Pandemics and human rights: three perspectives on human rights assessment of strategies against COVID-19, SCHEININ Martin and MOLBÆK-STEENSIG Helga, 2021, fq.20, <https://cadmus.eui.eu/handle/1814/69576>

2 Ibid. fq.20

3 "Frequently Asked Questions on a Human Rights-based Approach to Development Cooperation", Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, . fq.15, <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/FAQen.pdf>

4 UN Statement of Common Understanding on Human Rights-Based Approaches to Development Cooperation and Programming (the Common Understanding), https://unsdg.un.org/sites/default/files/6959-The_Human_Rights_Based_Approach_to_Development_Cooperation_Towards_a_Common_Understanding_among_UN.pdf

Në mënyrë më të detajuar, *qasja e bazuar në të drejtat e njeriut është një kornizë metodologjike që synon të integrojë të drejtat e njeriut në çdo program zhvillimor dhe (...) siguron përfshirjen dhe forcimin e konsiderueshëm dhe sistematik të kategorive më të cënueshme*⁵. Ai përpiqet t'u japë kuptim dhe jetë të plotë standardeve të të drejtave të njeriut të miratuara botërisht, duke i kaluar ato nga margjinat e debateve të ekspertëve dhe proklamimeve të zakonshme tek qendrat e vendimmarrjes dhe qeverisjes. Por QBDNJ është shumë më tepër se operacionalizimi i standardeve dhe parimeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Gjegjësisht, ajo nënkupton ndryshim të fokusit dhe motiveve për zbatimin e politikave publike, që e zhvendos fokusin nga plotësimi i nevojave tek realizimi i të drejtave. Kjo do të thotë se njerëzit nuk janë përdorues pasivë të shërbimeve, por bartës të të drejtave⁶ të cilët mund të kërkojnë realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre nga bartësit e detyrimeve⁷ të cilët duhet të sigurojnë realizimin e tyre. Nisur nga kjo, kur zbatohet kjo kornizë metodologjike, politika publike konceptohet dhe realizohet në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut të individëve. Është e rëndësishme të theksohet se QBDNJ-ja ka dobi për të gjithë qytetarët, por kërkon veprim prioritar për më të cënuarit, sepse të drejtat e tyre njerëzore shpesh mohohen ose mbeten të paplotësuara - "Leave no one behind"⁸. Së fundmi, QBDNJ vendos bartësit e të drejtave pas "timonit" të veprimit si agjentë kryesorë në krijimin e politikave - "Nothing about us without us"⁹!

Gjatë hartimit të politikave, duke përdorur një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, krijuesit duhet të marrin parasysh tre komponentat kryesore në vijim¹⁰:

- Statusi aktual i të drejtave të njeriut, në kushtet në të cilat do të zbatohet politika, përcaktohet përmes një perspektive specifike analitike¹¹ për bartësit e të drejtave dhe bartësit e detyrimeve, në mënyrë që të përcaktohet statusi i vërtetë i të drejtave të njeriut, si dhe përkushtimin e autoriteteve për t'i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur ato,
- Identifikimi i grupeve specifike të cënueshme që duhet të përfitojnë nga aktivitetet e propozuara,

5 Manual për aplikimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, Goce Kocevski, Maja Atanasova, Natali Petrovska, Darko Avramovski, Ena Bendevska, Maja Stojanoska, , Instituti për të Drejtat e Njeriut, fq.6, <https://bit.ly/3HdRo1v>

6 Bartës të të drejtave janë të gjithë njerëzit, në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

7 "Bartësit e detyrimeve janë ata persona që kanë një detyrë konkrete për të respektuar, mbrojtur, promovuar dhe përmbushur të drejtat e njeriut dhe që përmbahen nga cenimi i të drejtave të njeriut.

8 Leave No One behind, UN Sustainable Development Group, <https://unsdg.un.org/2030-agenda/universal-values/leave-no-one-behind>

9 "Nihil de nobis, sine nobis" është një slogan i përdorur për të përcjellë idenë se asnjë politikë nuk duhet të vendoset nga asnjë lloj zyrtari pa pjesëmarrjen e plotë dhe të drejtpërdrejtë të anëtarëve të grupit (dhe) që janë të ndikuar nga politika në fjalë.

10 "Zbatimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në politikat dhe proceset e programeve institucionale", Instituti i të drejtave të njeriut, <https://bit.ly/3peRtvG>

11 Ibid. fq. 13

- Fokus mbi parimet e të drejtave të njeriut.

Le t'u drejtohem tani parimeve të të drejtave të njeriut, të cilat janë themelore për zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, veçanërisht në kohë krize shëndetësore, dhe që drejtojnë miratimin dhe zbatimin e pothuajse çdo politike apo procesi programor.

Universaliteti dhe patjetërsueshmëria

Parimi i universalitetit të të drejtave të njeriut është themeli i ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe nënkupton që ne të gjithë kemi të drejtë të barabartë për të drejtat tona njerëzore (rëndësi absolute e të drejtave për këdo, kudo dhe në çdo kohë). Të drejtat e njeriut janë gjithashtu të patjetërsueshme, gjegjësisht personi nuk mund të privohet nga ato, përveç në situata specifike dhe duke ndjekur një procedurë përkatëse¹².

Në kontekstin e QBDNj-së, kjo do të thotë se shteti ka për detyrë të mendojë për të gjithë, jo vetëm për grupet sociale më të mëdha apo më të dukshme. Ky aspekt i universalitetit zbatohet përmes koncepteve si mosdiskriminimi dhe kushtimi i vëmendjes së veçantë grupeve të cenueshme. Në kontekstin e Kovid-19, kriza mund të nënkuptojë, për shembull, të mendosh se cilat bashkësi ose individë do të mund të ishin veçanërisht të cenueshëm ndaj virusit ose efekteve të tij, ose cilat bashkësi mund të mos përfitojnë plotësisht nga përgjigja që ka zhvilluar shteti ndaj krizës shëndetësore. Andaj, shteti ka detyrimin të miratojë, për shembull, masa që do të parandalojnë varfërimin dhe marginalizimin e mëtejshëm të bashkësive të cenueshme, për shkak të krizës ose për shkak të efektit joproporcional të kufizimeve të të drejtave të këtyre grupeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse efekti joproporcional i masave pandemike mbi njerëzit e cenueshëm mund të nënkuptojë gjithashtu diskriminim indirekt, nga mosadresi i nevojat specifike të këtyre bashkësive. Parimi i universalitetit nënkupton të menduarit rreth asaj nëse masa e parashikuar identifikon se kush është i cenueshëm, i marginalizuar dhe i përjashtuar, si dhe nëse i kushtohet vëmendje e mjaftueshme nevojave të grupeve të cenueshme, si gratë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara etj.?

¹² Ju mund të lexoni më shumë rreth këtij parimi në "The Universality of the Concept of Human Rights.", Henkin, Louis, The Annals of the American Academy of Political and Social Science 506 (1989): 10-16. <http://www.jstor.org/stable/1046650>

Pandashmëria

Parimi i pandashmërisë nënkupton që të drejtat e njeriut janë njëloj të rëndësishme¹³. Andaj, kur merret parasysh ky parim përmes prizmit të QBDNj, pyetja kryesore që lind është nëse disa të drejta perceptohen si më të rëndësishme se të tjerat, në dëm të ushtrimit të njërës palë të të drejtave? Për shkak se të drejtat rrjedhin nga dinjiteti i njeriut, mohimi i një të drejte pengon gjithmonë gëzimin e të drejtave të tjera.

Në kontekstin e Kovid-19, për shembull, do të nënkuptonte që e drejta për një standard të përshtatshëm jetese ose e drejta për arsimim nuk mund të rrezikohet në kurriz të një të drejte tjetër, siç është e drejta për shëndet. Kjo do të thotë se gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve për t'iu përgjigjur krizës shëndetësore, duhet të shmanget "prioriteti i të drejtave", si dhe të shmangen aktivitetet që mund të shkaktojnë këtë. Arsyeja për këtë është fakti se nëse i jepet përparësi një të drejte, në terma afatgjatë cenohet qëndrueshmëria e rezultateve dhe gjithashtu i lihet hapësirë përsëritjes së kushteve dhe cikleve të njëjta që trajtohen me ndërhyrje konkrete.

Ndërvarësia dhe ndërlidhja

Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura dhe të ndërlidhura. Përmbushja e një të drejte shpesh varet tërësisht ose pjesërisht nga përmbushja e të tjerave.

Në kontekstin e krizës shëndetësore, merrni për shembull të drejtën për shëndet dhe të drejtën për akses në informacion. Përhapja dhe akses në informacionin shëndetësor, i cili është i nevojshëm për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e dikujt, por edhe për të kuptuar, për t'iu përgjigjur dhe për të marrë pjesë në vendimmarrjen publike (ose nganjëherë private), ka një rëndësi të veçantë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Konventa e Aarhusit vendos standarde të qarta për këtë, duke thënë: *Në rast të një kërcënimi të menjëhershëm për shëndetin e njeriut ose mjedisin. i gjithë informacioni që mund t'i mundësojë publikut të marrë masa për të parandaluar ose zbutur dëmin që rrjedh nga kërcënimi, e që posedohet nga një autoritet publik, shpërndahet menjëherë dhe pa vonesë tek anëtarët e publikut që mund të preken*¹⁴. Në kontekstin e Kovid-19, shtetet kanë një detyrim pozitiv për të zbuluar në mënyrë proaktive informacione kyçe në lidhje me politikat shëndetësore, ekonomike dhe sociale dhe informacione të tjera në kohë urgjence ose krize¹⁵.

¹³ Më shumë për pandashmërinë e të drejtave mund të gjeni në "Human Rights: a thorny path" (2008), Hessel, Stéphane, Noce, Vincent, The UNESCO courier, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000183347>

¹⁴ Neni 5(c) nga Konventa e Aarhusit, cep43e.pdf (unece.org)

¹⁵ Më shumë për këtë çështje në "The right to information in times of crisis: access to information – saving lives, building trust, bringing hope!", Mendel Toby, Notess Laura (2020), UNESCO, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000374369>

Pjesëmarrja

Parimi i pjesëmarrjes nënkupton që secili ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet që prekin të drejtat e tij njerëzore. Pjesëmarrja duhet të jetë aktive, e lirë, domethënëse dhe të adresojë çështjet e qasshmërisë, duke përfshirë qasjen në informacion në një formë dhe gjuhë që individët mund ta kuptojnë.

Në kontekstin e Kovid-19, kjo mund të kuptohet në drejtim të rëndësisë së konsultimit dhe pjesëmarrjes së anëtarëve të komunitetit dhe kategorive të cenueshme të personave që preken drejtpërdrejt nga masat e marra. Andaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që shteti dhe bartësit e detyrimeve të sigurojnë që të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë komunitetet, shoqërinë civile, grupet e marginalizuara, grupet e përjashtuara etj, të përfshihen aktivisht në krijimin e politikave, programeve dhe masave, si dhe në vendimmarrje.

Përgjegjësia dhe sundimi i ligjit

Sundimi i ligjit nënkupton që të gjithë personat duhet të mbajnë përgjegjësi para ligjit, pra të përballen me pasojat sociale dhe juridike të shkeljes së ligjit¹⁶. Në mënyrë që ligji, e rrjedhimisht dhe sundimi i të drejtës të ketë një funksion real shoqëror, aktorët shoqërorë duhet të kenë detyrimin për ta respektuar atë, ndërsa shoqëria duhet të jetë e aftë që t'i mbajë ata përgjegjës. Nisur nga kjo, parimi i përgjegjësisë i referohet faktit se shtetet dhe bartësit e mbetur të detyrimeve janë përgjegjës për realizimin e të drejtave të njeriut. Në praktikë, kjo nënkupton qartë identifikimin e të drejtave të bartësve të kërkesave dhe identifikimin e detyrave të bartësve të detyrimeve. Kjo nënkupton ekzistencën e mundësisë për të lokalizuar përgjegjësinë në rast të shkeljes së të drejtave, si dhe ekzistencën e mekanizmave të qartë të hetimit. Për më tepër, llogaridhënia nënkupton që të gjithë aktorët e përfshirë janë përgjegjës për veprimet e tyre dhe se rezultatet dhe proceset monitorohen dhe vlerësohen. Ky parim nuk iu referohet vetëm gjykatave, por edhe shumë sistemeve të tjera, siç janë procedurat administrative. Në kontekstin e Kovid-19, përgjegjësia mund të nënkuptojë, për shembull, mes tjerash, një situatë në të cilën sistemi i kujdesit shëndetësor pranon dhe u përgjigjet ankesave për kujdes joadekuat.

Barazia dhe mosdiskriminimi

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit do të thotë që të gjithë individët janë të barabartë si qenie njerëzore dhe askush nuk duhet të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, gjuhës, orientimit seksual, fesë,

¹⁶ "The rule of law and transitional justice in conflict and post-conflict societies", UN Secretary-General, Report to the Security Council, 23 August 2004, UN Doc. S/2004/616, <https://digitallibrary.un.org/record/527647>

opinionit politik apo ndonjë opinionit tjetër, origjinës kombëtare, sociale ose gjeografike, aftësisë së kufizuar, pasurisë, lindjes ose ndonjë statusi tjetër.

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut nënkupton që të gjitha format e diskriminimit në ushtrimin e të drejtave të njeriut duhet të ndalohen, parandalohen dhe eliminohen. Kjo qasje, në kontekstin e pandemisë Kovid-19 dhe përgjigjes së qeverisë, shqyrton nëse masat e marra diskriminojnë në mënyrë të pajustificueshme kategori të ndryshme personash – që do të thotë kërkon t'u jepet përparësi atyre që janë më të marginalizuar dhe që përballen me barrierat më të mëdha në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Prandaj, mund të konkludojmë se ka shumë përfitime të mëdha nga përdorimi i një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, jo vetëm në formësimin e politikave publike (duke përfshirë masat, strategjitë dhe vendimet përmes të cilave ato zbatohen), që cilat janë fokusi i këtij punimi, por dhe në krijimin e programeve të zhvillimit, proceseve gjyqësore dhe në përfaqësimin. Aplikimi i kësaj metode i jep legjitimitet politikës, sepse QBDNj bazohet në të drejtën ndërkombëtare dhe është e pranuar globalisht. Për më tepër, ajo vë në radhë të parë popullsinë e marginalizuar dhe të cenueshme dhe siguron përfshirjen e saj, duke siguruar kështu realizimin e të drejtave të njeriut për të gjithë.

2.

PASQYRË E PËRGGJIGJES SË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NDAJ KRIZËS SHËNDETËSORE TË SHKAKTUAR NGA KOVID-19 DHE NDIKIMI I SAJ TE QYTETARËT

2.1.

Konteksti politik në periudhën e shfaqjes së Kovid-19 në RMV

Rasti i parë me koronavirus në RMV u zbulua më 26 shkurt 2020, në një periudhë zhvillimesh komplekse politike në vend. Konkretisht, më 3 janar 2020 u zgjodh Qeveria teknike (kalimtare), me mandat për zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Më 16 shkurt, kryeparlamentari shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhjet për 12 prill, rreth tetë muaj para përfundimit të mandatit parlamentar, të cilat më pas u shtynë për 15 korrik 2020.

Më 13 mars u regjistrua shfaqja e grupit të parë të Kovid-19 në Dibër dhe Centar Zhupa, ku u shpall karantinë e plotë¹⁷. Kërcënimet e pandemia ndaj qytetarëve, shëndetit publik dhe ekonomisë, si dhe nevoja për marrjen e masave urgjente dhe efektive për përballimin e saj, ishin arsye të mjaftueshme që qeveria teknike t'i parashtrojë një propozim presidentit të RSM-së, duke theksuar arsyet për shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme.

2.2.

Gjendja e jashtëzakonshme dhe sundimi i së drejtës

Më 18 mars 2020, presidenti i Republikës për herë të parë në ekzistencën e Republikës së Maqedonisë së Veriut shpalli gjendje të jashtëzakonshme¹⁸ për hir të mbrojtjes dhe përballimit me pasojat e koronavirusit, gjë pas së cilës Qeveria, në përputhje me nenin 126 të Kushtetutës së RMV-së, fitoi autoritetin për miratimin e dekretëve me fuqi ligjore, deri në përfundimin e tij më 23.6.2020. Gjendja e jashtëzakonshme nënkuptonte jo vetëm futjen e masave të shtuara për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, por *implikon(te) edhe futjen e një sistemi të veçantë juridik, karakteristikat themelore të të cilit janë: largimi nga parimi i ndarjes së*

¹⁷ Të gjitha masat e marra dhe rekomandimet e miratuara janë në dispozicion në: <https://vlada.mk/node/20502>

¹⁸ Presidenti i RMV-së mori pesë vendime për konstatimin e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e gjithë vendit, me qëllim mbrojtjen dhe përballimin e pasojave të përhapjes së KOVID-19, të publikuar më 18.3.2020, 17.4. 2020, 17.5. 2020, 31.5.2020. dhe 15.6.2020, <http://slvesnik.com.mk/besplaten-pristap-do-izdanija.nspx#>

pushteteve dhe marrja e pushteteve legjislative nga ana e qeverisë, mundësinë për të kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe marrjen e masave ndërhyrëse nga ana e pushtetit ekzekutiv në ekonomi, arsim dhe sfera të tjera të jetës shoqërore¹⁹. Nisur nga kjo, është jetike që kompetencat emergjente të ushtrohen vetëm për qëllimet për të cilat ato janë dhënë dhe se kufizimet e lirive dhe të drejtave nuk mund të jenë diskriminuese në bazë të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, statusit të pronës ose statusit social²⁰, pra qeveria duhet të respektojë parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, domosdoshmërisë dhe mosdiskriminimit.

Nga momenti i shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme deri më 22 qershor 2020, Qeveria kishte miratuar 250 dekrete²¹ me anë të të cilave rregullohej një gamë e gjerë çështjesh të rëndësishme në menaxhimin e krizës. Dekretet e miratuara i nënshtrohen kontrollit kushtetues-gjyqësor dhe kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, pra siç vlerëson vetë Gjykata Kushtetuese, ajo është kompetente të vlerësojë kushtetutshmërinë e Dekretit me fuqi ligjore nga aspekti i nenit 126 (a rregullon në mënyrë të drejtë dhe proporcionale masat me të cilat në mënyrë direkte ose indirekte do të largohen shkaqet që kanë çuar në shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe pasojat e saj...?), dhe nga aspekti i nenit 54 (a ka diskriminim në arsyet e deklaruara?) a shkelet e drejta? e cila nuk mund të dërgohet - as në gjendje të jashtëzakonshme, as në gjendje lufte dhe të drejtat e njohura ndërkombëtarisht - të cilat nuk mund të dërgohen²².

Në kuadrin e parimit të sundimit të së drejtës, i cili kërkon gjithmonë një qasje kufizuese dhe respektim të kërkesave të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, vihen në pyetje dekretet që rregullojnë disa të drejta që zgjatën deri në fund të vitit 2020, pavarësisht se sa zgjat gjendja e jashtëzakonshme, si dhe dekretet me fuqi ligjore që përmbajnë urdhëresën se një masë e caktuar zbatohet gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme “në rast se me këtë dekret nuk është rregulluar ndryshe”. Nisur nga kjo, i vetmi qëndrim i pranueshëm është që dekretet, efekti i të cilave e kalon kohëzgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme, të mbeten në sistemin juridik vetëm nëse legalizohen, gjegjësisht konfirmohen nga Kuvendi²³.

Për sa i përket domosdoshmërisë së dekretëve, ato në pjesën më të madhe, parashikonin norma që i referoheshin menaxhimit të krizës apo përballjes me paso-

19 “Analizë e aspekteve juridike të gjendjes së jashtëzakonshme”, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASH-AM) <https://urlzs.com/KCf7jfq.1>

20 Neni 54 i Kushtetutës së RMV.

21 101 dekrete i referoheshin zbatimit të një ligji të caktuar, ndërsa 41 janë të ashtuquajtura origjinale, domethënë rregullojnë një çështje që nuk është objekt i rregullimit të një ligji ekzistues, <https://vlada.mk/uredbi-covid19>

22 “Analizë e përvojave të institucioneve gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe dekretet me fuqi ligjore”, Ministria e Drejtësisë së RMV, shkurt 2021, fq. 16, <https://bit.ly/3phbYYS>

23 Supra note 19

jat e saj²⁴, që do të thotë se ato vendosin lidhjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë mes subjektit të tyre dhe pandemisë së KOVID-19 dhe pasojave të saj. Nga aspekti i proporcionalitetit, *parimi i proporcionalitetit nuk respektohet gjithmonë në dekretet që dërgojnë ligjet ekzistuese për shkak të mbrojtjes së shëndetit publik, ndërsa disa dekrete (...) ndryshohen shpesh, miratohen në mënyrë jotransparente dhe në periudhë jashtëzakonisht të shkurtër kohore, pa konsultime me palët e interesuara, ekspertët dhe sektorin civil.*²⁵ Në këtë drejtim, vihet re një disproporcion, për shembull në Dekretin 100/2020, i cili zgjati kohën e izolimit të rreptë për njerëzit që vijnë nga vendet me rrezik të lartë nga 14 në 21 ditë, gjë lidhur me të cilën në analizë thuhet se Dekreti *nuk përmban një arsye dhe shpjegim për vendosjen e masave më të rrepta kufizuese dhe nuk mund të vlerësohet nëse masa e marrë është proporcionale dhe e përshtatshme me situatën, duke qenë se standardet mjekësore të OBSH-së thonë se 14 ditë në izolim të rreptë janë të mjaftueshme që një person të shfaqë simptoma të koronavirusit.*²⁶

Krahas dekretëve, Qeveria miratoi një sërë aktesh të tjera, si vendime, rregullore dhe konkluzione me rëndësi të veçantë për organet shtetërore dhe punën e tyre në kushte emergjente.

2.3.

Ndalimi dhe kufizimi i lëvizjes

Me qëllim të mbrojtjes më të mirë të popullatës nga përhapja e koronavirusit, më 22 mars 2020, Qeveria miratoi vendim për ndalimin dhe regjimin e veçantë të lëvizjes së popullsisë dhe transportit publik në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut²⁷. Në bazë të vendimit në fjalë, u ndalua lëvizja e popullsisë dhe lëvizja e automjeteve të transportit publik në territorin e RMV-së në periudhën nga ora 21:00 deri në orën 6:00 të ditës së nesërme. Me këtë Vendim u konfirmua sërish ndalimi i tubimeve të qytetarëve në grupe prej më shumë se pesë persona gjatë periudhës kur lejohet lëvizja. Pas miratimit të kësaj mase, Qeveria njoftoi se shkelja e saj do të nënkuptonte përgjegjësi penale, sipas nenit 206 të Kodit Penal. Vendimi për ndalim dhe regjim të veçantë të lëvizjes pësoi disa ndryshime, të cilat më së shumti i referoheshin ndryshimit të orës së lëvizjes gjatë ditës, ndalimit të lëvizjes për disa ditë (karantinë), gjatë fundjavave dhe festave, ndalimit dhe regjimit të veçantë të lëvizjes të personave mbi 67 vjeç dhe të personave deri

24 "Analizë e dekretëve të miratuara me fuqi ligjore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në vitin 2020" Blueprint Group, Qendra për hulumtime dhe analiza juridike, fq.85, https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/11/analiza-na-donesenite-uredbi-so-zakonska-sila-za-vreme-na-vonrednata-sostojba-vo-2020_bluprint.pdf

25 Supra note 19 fq.15

26 Supra note 24

27 Vendim për ndalimin dhe regjimin e veçantë të lëvizjes në territorin e RMV. "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 72/2020, <https://www.slvesnik.com.mk/issues/efd6cd84b37e40a19e3f75515b759d06.pdf>

në 18 vjeç²⁸ dhe regjimit të veçantë të lëvizjes vetëm në komuna të caktuara, për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve me koronavirus. Ky Vendim pushoi plotësisht më 22 qershor 2020.

Këto ishin disa nga masat më të rrepta të marra për të luftuar pandeminë. Ato kufizuan rëndë lirinë e lëvizjes dhe prekën një gamë të gjerë të të drejtave civile dhe politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Nisur nga kjo, është e qartë se fokusi primar i shtetit ishte zbatimi i distancimit fizik përmes masave kufizuese, qasje e cila sipas autorëve të dokumentit të shkurtër politik "*Ballkani perëndimor gjatë pandemisë globale*", zbulon se marrëdhënia ndërmjet shtetit dhe shoqërisë (të Ballkanit perëndimor) është formuar nga mosbesimi i ndërsjellë²⁹. Neglizhenca sistematike e sistemit të kujdesit shëndetësor (dekada të tëra mungese vullneti për të promovuar dhe investuar, si dhe eksodi masiv i personelit mjekësor të trajnuar dhe me arsim të lartë³⁰, të cilët po emigrojnë) në thelb, *ka bërë më të mundshme për të arritur deri te masat e ashpra, duke qenë se spitalet kanë më pak resurse për t'u marrë me raste më serioze, gjë që rriti urgjencën për të parandaluar çdo përhapje të mëtejshme të virusit Kovid-19.*³¹ Megjithatë, ndalimi dhe mbyllja e të gjithë popullatës pa përjashtim (përveç në rastet e urgjencave tejet të mëdha dhe punonjësve kyç si policia, forcat e armatosura, punonjësit e shëndetësisë, pjesëmarrësit në procesin e prodhimit në bujqësi), nuk është as proporcionale dhe as nuk shërben për të luftuar pandeminë. Kjo qasje do të thotë se shteti krijon politika të bazuara në *mitin mbi mentalitetin*³², dhe jo nëpërmjet një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, duke shpresuar se kjo do të parandalojë përhapjen e virusit dhe do të lehtësojë prisionin në sistemin shëndetësor. Si rezultat i vendimmarrjes dhe veprimit të tillë, qeveria ka neglizhuar nevojat e disa kategorive të cenueshme të personave, si: të moshuarit që varen nga kujdesi i të tjerëve, viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore, punëtorët seksualë, romët, fëmijët, kërkuesit e azilit etj.

Sipas eksperiencave të pjesëmarrësve në fokus grupet e organizuara gjatë orës policore dhe fundjavave të gjata në karantinë, numri i raportimeve për **dhunë në familje** është rritur. Për të ilustruar këtë, u nda një rast kur viktimat e dhunës në

28 Vendimi pati një efekt ndeshës dhe diskriminues ndaj grupeve të caktuara shoqërore.

29 Policy Brief "The Western Balkans in Times of the Global Pandemic", April 2020, The Balkans in Europe Policy Advisory Group, Florian Bieber, Karl-Franzens, Tena Prelec, Marika Djolai, Donika Emini, fq.7, https://www.researchgate.net/publication/341700199_The_Western_Balkans_in_Times_of_the_Global_Pandemic

30 Raporti "Sistemet shëndetësore në veprim – Maqedonia e Veriut" vë në dukje se në sektorin e shëndetësisë ka mungesë të vazhdueshme të mjekëve dhe infermierëve, por megjithatë, p.sh. numri i mjekëve u rrit nga 269 për 100,000 banorë në 2010, në 312 në 2019, duke iu afruar mesatares së BE-së prej 382. Mund të lexoni më shumë në "Sistemet shëndetësore në veprim - Maqedonia e Veriut", Julianne W., Florian T., Julia L. dhe Bernd R., WHO, <https://apps.who.int/iris/rest/bitstreams/1405296/retrieve>

31 Supra note 29, fq.7

32 "Gjendja e demokracisë në Maqedoninë e Veriut në kohët e pandemisë Kovid-19", Katerina Kolozova me një ekip nga ISSHS, fq.7, <https://www.isshs.edu.mk/wp-content/uploads/2020/04/Shteti-e-demokracisë-në-Maqedoninë-veriore-në-kohë-të-Covid-19-Pandemia.pdf> fq.7,

familje i kërkoi ndihmë policisë dhe policia refuzoi ta mbronte, me arsyetimin se bashkëshorti i saj, autori i dhunës, ishte pozitiv me Kovid-19. Në të njëjtin drejtim është edhe “Rrjeti për mbrojtjen nga diskriminimi” i cili konstaton se *në përvajshimet që mund të lëvizin gjatë ndalesës, viktimat e dhunës në familje nuk janë parashikuar fare, ndërkohë që në kushtet emergjente dhe ndalimit të lëvizjes gjatë ditës dhe izolimit në karantinë, rreziku i dhunës në familje është rritur, gjë që mund të ketë pasoja kërcënuese për jetën*³³. Për më tepër, sipas raportit të “Rrjetit kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”³⁴ për shkak të pranisë fizike të dhunuesve, gratë nuk ishin në gjendje të telefononin linjat e ndihmës ose të raportonin dhunën, dhe shumë gra kishin frikë të kërkonin kujdes shëndetësor dhe ndihmë mjekësore apo të largoheshin nga mjedisi i dhunshëm dhe të vendoseshin në qendra për viktimat e dhunës në familje, për shkak të rrezikut të infektimit me Kovid-19. Pas reagimeve të organizatave të shoqërisë civile, që punojnë me të drejtat e njeriut, shteti ka bërë përvajshim, që gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe fëmijët e tyre të mund të largohen nga shtëpia në rast kërcënimi serioz gjatë kohës së ndalimit të lëvizjes, pa frikë se do të ndëshkohen.

Kufizimet në lëvizje, së bashku me rekomandimet e qeverisë për distancim fizik, e kanë vështirësuar plotësimin e nevojave jetike të **romëve** të përfshirë në ekonominë informale, si grumbulluesit e plastikës dhe hekurit, të cilët janë përballur me rënie të të ardhurave ditore për shkak të hapësirës më të vogël kohore në dispozicion për të lëvizur dhe për shkak të stanjacionit të flukseve ekonomike sa i përket riblerjes së asaj që mbledhin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse rreth 40% e romëve në RMV janë të përfshirë në mënyra joformale të përfitimit³⁵.

Sipas të dhënave të grupeve të fokusit, kufizimet në lëvizje, karantina dhe ora policore kanë ndikuar në mënyrë direkte **punëtorët seksualë** të cilët ishin të kufizuar në punën e tyre gjatë kësaj periudhe, ndonëse për shumicën prej tyre ky është burimi i vetëm i përfitimit. Duke pasur parasysh faktin se shteti nuk arriti t’u jepte asistencë këtyre personave³⁶, disa prej tyre duhej të punonin edhe gjatë orës policore (duke rrezikuar kështu përgjegjësinë penale për mosrespektim të masave) dhe vareshin nga organizatat qytetare sa i përket ndihmës bazë, p.sh. si ushqim, veshje, kupona ushqimorë dhe më shumë.

33 “Të drejtat e njeriut për komunitetet e marginalizuara në kushtet e Kovid-19”, Natasha Boshkova, Darko Antikj, Rosana Bogatinova dhe Margarita Gliguroska, Rrjeti për Mbrojtje nga diskriminimi, shkurt 2020, <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2021/06/izvestaj-za-covekovi-prava-na-mz-za-web.pdf> fq. 32

34 “Përballja me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor gjatë dhe pas krizës shëndetësore me Kovid-19”, Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/ngarkime/2020/09/Spravuvane-so-nasilstvo-vrz-zheni-i-semejno-nasilstvo-za-vreme-na-KOVID-19.pdf>

35 Sfidat e romëve gjatë krizës së shkaktuar nga Kovid-19, M-r Ismail Kamberi, Instituti për Politika Evropiane, maj 2020, fq.8, Sfidat-për-romët-për-kohë-të-kriza-shkaktuar-nga-KOVID-19.pdf (merc.org.mk)

36 Janë të përvajshuar nga sistemi i ndihmës dhe mbështetjes së qeverisë dhe nuk kanë mundur të përdorin masa socio-ekonomike për shkak se puna e tyre nuk njihet ligjërisht.

Vendimi për ndalimin e lëvizjes ishte poashtu **i pakonsideruar mirë sa u përket gjinive**, sepse nuk u vunë në pah rolet e veçanta gjinore të grave në RMV, të cilat shpesh kujdesen për të moshuarit dhe anëtarët e familjes me sëmundje kronike, duke shkaktuar frikë dhe frustrim nga ata që japin dhe ata që marrin kujdes³⁷.

Sa u përket **personave më të moshuar**, me vendimin që personat mbi 67 vjeç mund të lëvizin vetëm për dy orë në një periudhë të caktuar të ditës, *të drejtat e kësaj kategorie të personave janë kufizuar në mënyrë të papërshtatshme dhe të paarsyetuar*,³⁸, gjegjësisht duke shkaktuar keqkuptime dhe gjuhë të urrejtjes të panevojshme ndaj të moshuarve nga ana e qytetarëve të tjerë, pa e arritur qëllimin kryesor – reduktimin e sëmundjeve Kovid-19 në këtë grup moshë. Në këtë drejtim, në lidhje me vendimin për regjimin e veçantë të lëvizjes së personave mbi 67 vjeç dhe personave nën 18 vjeç, edhe vetë Gjykata Kushtetuese ka shprehur dyshime rreth arsytimit, duke nisur kështu procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij. Në përputhje me mendimet e Gjykatës, lind pyetja nëse trajtimi selektiv dhe i veçantë i qytetarëve, sipas moshës së tyre, është proporcional dhe interesin publik në një shoqëri demokratike dhe nëse ai mund të vërtetohet si i nevojshëm dhe legjitim? *Ndërhyrja në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në kushtet e një pandemie që ka kapluar edhe qytetarët në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të ketë bazë, nëse ka proporcionalitet të masave për të kufizuar situatën në fjalë, me qëllim që të arrihen synimet e vendosura shëndetësore për ndalimin e përhapjes së epidemisë.*³⁹

Kufizimi i lëvizjes në mënyrë disproporcionale i ndikoi edhe **kërkuesit e azilit dhe persona që qëndronin ilegalisht në RMV**. Gjegjësisht, në përputhje me vendimin e Qeverisë, *gjatë periudhës së emergjencës për shkak të virusit KOVID-19, të gjithë azilkërkuesit e rinj, si dhe personat e sapo identifikuar pa vendbanim të rregulluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, fillimisht janë vendosur në karantinë për 25 ditë në Qendrën transitore Vinojug – Gjevgjeli*.⁴⁰ Ky vendim është marrë pa shpjegime apo analiza të veçanta për nevojën e futjes së një periudhe kaq të gjatë karantine, e cila është në kundërshtim me udhëzimet e OBSH-së.

37 "Analiza e ndikimeve të kovid-sars-19 mbi gjininë dhe diversitetin", D-r Marija Risteska, Qendra për hukumtim dhe krijim të politikave, fq.20, <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

38 Supra note 33, fq.34

39 Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.60/2020, <http://ustavensud.mk/?p=19320>

40 Pika 18 nga Procesverbali i seancës së 28-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbajtur më 25.3.2020, <https://vlada.mk/sednica/2020-28>

2.4.

Shëndeti Publik

Pandemia pati një ndikim të madh në shëndetin e popullatës dhe në vdekshmërinë në RMV. Deri në fillim të gushtit 2021, ishin regjistruar gjithsej 156.452 infeksione dhe 5493 vdekje të lidhura me sëmundjen, duke treguar kështu një shkallë vdekshmërie nga Kovid-19 që ishte dyfishi i mesatares së Rajonit evropian të OBSH-së⁴¹.

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe interesit publik, në krijimin e politikave në fushën e shëndetit publik, RMV pranoi dhe zbatoi plotësisht udhëzimet për veprimin dhe menaxhimin e koronavirusit, të ofruara nga OBSH. Gjegjësisht, për një koordinim më të mirë në nivel kombëtar, në kuadër të Ministrisë së shëndetësisë u formua një grup krize, në të cilin u përfshinë ekspertë të fushës së epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive, me qëllim menaxhimin më të mirë të të gjitha informacioneve dhe aktiviteteve lidhur me rastet e koronavirusit, koordinimin e të gjitha aktiviteteve me institucionet e tjera dhe me rekomandimet e dhëna nga Qendra për menaxhimin e krizave. Strategjia që u aplikua në krijimin e përgjigjes shëndetësore bazohej në zbatimin e masave të shëndetit publik për reduktimin e transmetimit të virusit në formën e ndërhyrjeve për mbrojtjen personale, mbrojtjen e mjedisit, distancimin social dhe ndërhyrjeve në lidhje me udhëtimet. Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar 37 protokolle, rekomandime, udhëzime dhe algoritme për Kovid-19⁴², të cilat mes tjerash, dhanë udhëzime për mënyrën e veprimit të mjekëve të familjes në testimin dhe trajtimin e pacientëve me Kovid-19, për kujdesin në shtëpi të pacientëve me simptoma të lehta të Kovid-19, rekomandime për pacientët me sëmundje të rralla që kanë dëmtime multisistemike të disa organeve dhe që përfshihen në popullatën “në rrezik”, protokoll për trajtimin e pacientëve në hemodializë etj. Po ashtu, për t’iu përgjigjur kërkesave për zbulimin dhe veprimin në rastet e dyshimta në pikat kufitare, shteti ka miratuar protokolle përkatëse. Pas marrjes së vaksinës, vaksinimi dhe ndërhyrjet e këtilla vazhduan të jenë mjete të rëndësishme për të reduktuar transmetimin dhe për të parandaluar përhapjen e virusit.

Kapaciteti i kufizuar i sistemit shëndetësor

Pavarësisht numrit të madh të masave të zbatuara, numri i të infektuarve dhe vdekjeve është rritur sidomos gjatë valës së dytë dhe të tretë, në fund të vitit 2020, gjegjësisht në pranverën e vitit 2021.⁴³ Në këtë situatë kishte mungesë të

⁴¹ Supra note 30, fq.20

⁴² Të disponueshme në ueb faqen e Ministrisë së shëndetësisë: <http://zdravstvo.gov.mk/preporaki-protokoli-izvestuvanja-dokumenti-za-covid-19/>

⁴³ Maqedonia e Veriut: Profili i vendit për pandeminë e koronavirusit, i disponueshëm në: <https://ourworldindata.org/coronavirus/country/macedonia>

vendeve në klinika për pritjen e pacientëve që duhej të shtroheshin në spital, gjë që shtronte çështjen e të drejtës universale të aksesit në kujdesin shëndetësor, sepse trajtimi në spitalet private, me çmime tejet të larta, ishte një privilegj për pak njerëz. Sipas të dhënave të grupit të fokusit, problemi më i madh në përgjigjen shëndetësore ndaj krizës së Kovid-19 ishte kapaciteti i kufizuar i sistemit shëndetësor për t'u kujdesur për të gjithë pacientët që kanë nevojë për kujdes shëndetësor gjatë pandemisë, ndaj shumë qytetarë u detyruan të përdorin shërbimet e institucioneve private shëndetësore, të cilat kushtojnë dukshëm më shumë. Sipas shoqatave, qytetarët kanë marrë kredi për të përballuar shpenzimet e mjekimit dhe nga ana tjetër nuk ka asnjë mekanizëm që garanton kthimin e këtyre mjeteve nga Fondi i sigurimeve shëndetësore. Kjo situatë çon në varfërim të mëtejshëm të qytetarëve, në kushte të një krize ekonomike dhe shëndetësore. Në vitin 2020, organizatat qytetare kërkuan nga shteti të vendosë një kuadër ligjor për trajtimin mjekësor lidhur me Kovid-19, të cilin qytetarët mund ta mbulojnë me mjete personale në institucionet private shëndetësore, sipas shembullit të shumës maksimale të përcaktuar për pagesën e pjesëmarrjes me mjete personale (participim) në shëndetin publik, në përputhje me çmimoren e shërbimeve shëndetësore të Fondit të sigurimeve shëndetësore, si dhe të lidhet marrëveshje ndërmjet Fondit të sigurimeve shëndetësore me të gjithë laboratorët e akredituar për testin PCR, për të përcaktuar praninë e Sars-CoV.-2 virus, ose për të mundësuar rimbursimin e kostos.⁴⁴ Në prill të vitit 2021, në seancën e 65-të, Qeveria e RMV-së përcaktoi ndryshimet dhe shtimet në Ligjin për kujdesin shëndetësor, me të cilat, ndër të tjera, u rregullua edhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë shëndetësore nga institucionet private shëndetësore në rastin e vërtetimit të një krize, me qëllim që të mbrohet shëndetin publik dhe u shpall epidemia ose pandemia e një sëmundjeje ngjitëse, si dhe u mundësua autoriteti ligjor për vendosjen e çmimeve më të larta në spitalet private, në masën e çmimeve të referencës të përcaktuara nga Fondi i sigurimeve shëndetësore. Megjithatë, *deri më sot, Qeveria nuk i ka caktuar çmimet, gjegjësisht nuk ka marrë vendim apo çfarëdolloj akti, kështu që kjo dispozitë ligjore mbetet e pazbatuar, ndërsa shërbimet e institucioneve private mbeten në dispozicion vetëm për një numër të kufizuar të qytetarëve që kanë mjete të mjaftueshme financiare*⁴⁵.

44 Për t'i dhënë fund përfitimit në një kohë krize që rrezikon jetën, <https://urlzs.com/D9KAM>

45 Raport vjetor 2021- Efikasiteti i mbrojtjes juridike të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj, fq.21, <https://bit.ly/3M18Yt1>

Vaksinimi

Më 26.1.2021 Qeveria miratoi Planin nacional për vaksinim kundër Kovid-19 në RMV⁴⁶ dhe në këtë mënyrë përcaktoi procesin e vaksinimit të qytetarëve. Sipas planit, qëllimi kryesor i vaksinimit është luftimi i epidemisë së Kovid-19 dhe rimëkëmbja e sistemit shëndetësor dhe sistemit ekonomik në vend. Vaksinimi, në kombinim me masat e tjera parandaluese shëndetësore (mbajtja e maskës mbrojtëse, ruajtja e distancës fizike dhe higjienës së duarve), *do të kontribuojë në uljen e morbiditetit dhe mortalitetit të grupeve të rrezikut, uljen e shfaqjes së komplikimeve dhe vdekjeve, ruajtjen e funksioneve vitale të komunitetit dhe kufizimin e transmetimit të virusit mes popullsisë*⁴⁷. Në këtë plan, qeveria identifikoi kategoritë e njerëzve që duhet të mbrohen për të arritur qëllimin e vaksinimit, dhe ata ishin - *personat që janë thelbësorë në përgjigjen ndaj pandemisë dhe për kujdesin dhe trajtimin e të sëmurëve (punëtorët shëndetësorë); njerëz që mbajnë shërbimet thelbësore të komunitetit (infrastruktura kritike); si dhe personat që janë të ekspozuar ndaj një rreziku më të madh për shkak të komplikimeve dhe me pasojë vdekjen*.

Në këtë kontekst, është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se Avokati i popullit vuri në pah se personat me aftësi të kufizuara, si dhe ata që kujdesen për ta, nuk njihen si grupe prioritare për vaksinën. Shpjegimet për përfshirjen e tyre prioritare janë në drejtimin që ky grup qytetarësh përballet me rrezik të zmadhuar të infektimit me Kovid-19, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe dëmtimit të shëndetit, diçka karakteristike për shumë prej tyre, por edhe për shkak të kontaktit të përditshëm me ofruesit e shërbimeve për mbështetje, qofshin ata anëtarë të familjes së tyre ose persona të angazhuar për ofrimin e kujdesit, trajtimit, edukimit, për të cilat është praktikisht e pamundur ruajtja e distancës fizike.⁴⁸ Gjithashtu, sipas Avokatit të popullit, Qeveria duhet të ketë parasysh po ashtu se për përjashtimin joproporcional të personave me aftësi të kufizuara nga procesi i imunizimit mund të kontribuojë mungesa e informacionit për sistemet e regjistrimit për vaksinim, vendet e paarrtshme për imunizim, si dhe pikëpamjet stigmatizuese nga ana e profesionistëve shëndetësorë. Në këtë drejtim ishin edhe deklaratat e OQ-ve, të cilët gjatë fokus grupeve theksuan se te personat me aftësi të kufizuara, si grup heterogjen, kriza vetëm sa e ka përkeqësuar situatën dhe evidentuan problemet me të cilat përballen. Së pari, në mungesë të pikave të aksesit për testim dhe vaksinim për këtë kategori qytetarësh shteti nuk ka arritur ta përmbushë detyrimin e tij për përshtatjen e duhur dhe si rrjedhojë

⁴⁶Plani Kombëtar për vaksinimin për Kovid-19 në RMV, Ministria e Shëndetësisë e RMV, <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2021/02/Natsionalen-plan-za-imunizatsija.pdf>

⁴⁷Ibid fq.7

⁴⁸Mbishkrim "Avokati i popullit kërkon që personat me aftësi të kufizuara dhe ofruesit e shërbimeve të kenë përparësi për vaksinim", Akademik, <https://akademik.mk/harodniot-pravobranitel-bara-litsata-so-poprechenost-i-davatelite-na-uslugi-za-niv-da-imaat-prioritet-za-vaksinatsija/>

nuk ka siguruar gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuar në baza të barabarta me të tjerët.⁴⁹ Këta persona janë përballur edhe me probleme në aspekt të mosinformimit rreth sigurisë së vaksinës, si dhe nëse ata mund të marrin vendimet e tyre vetë kur bëhet fjalë për shëndetin e tyre.

Informacion mbi masat e miratuara

Me qëllim të informimit me kohë të qytetarëve për masat mbrojtëse dhe parandalimin e koronavirusit, statistikave dhe pyetjet e shpeshta, Qeveria zhvilloi fushata për shëndetin publik dhe hapi faqen e internetit <https://koronavirus.gov.mk/>. Ministri i shëndetësisë dhe Komisioni për sëmundjet infektive mbajtën konferenca të rregullta për media (të transmetuara në gjuhën e shenjave) për të informuar qytetarët rreth situatës. Në faqen e Ministrisë së shëndetësisë dhe Qeverisë së RMV-së, për qytetarët u vunë në dispozicion një numër i madh dokumentesh dhe informacionesh, si aplikacioni për shprehje të interesit për vaksinim kundër Kovid-19, broshura, udhëzime, pyetje dhe përgjigje, mite dhe të vërteta (në gjuhën maqedonase dhe shqipe) në lidhje me virusin, si dhe informacione dhe video edukative në lidhje me njohjen e simptomave, mënyrën e mbrojtjes, numrat e kontaktit me objektet shëndetësore, izolimin e duhur në shtëpi, informacione në lidhje me udhëtimet në shtete të rrezikut të mesëm dhe të lartë, si dhe informacione në lidhje me mbrojtjen e shëndetit psikik. Andaj, informacionet e prezantuara në publik nga Qeveria dhe institucionet kompetente ishin transparente, në kohë dhe në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut⁵⁰. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të bëra për të prezantuar vazhdimisht informacionet e rëndësishme për publikun, OQ të cilët morën pjesë në fokus grupet theksuan problemin e përhapjes së lajmeve të rreme dhe rritjen e gjuhës së urrejtjes gjatë pandemisë, veçanërisht në internet. Në përgjigje të kësaj situatë, shumë shoqata zhvilluan aktivitete për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për respektimin e masave duke shkëmbyer informacione të qarta, transparente dhe të bazuara në shkencë, si dhe përmes aktiviteteve që synojnë reduktimin e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike dhe politike⁵¹.

⁴⁹ Sipas Ligjit për Parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, pamundësia për t'u përshtatur në mënyrë adekuate paraqet diskriminim.

⁵⁰ "Raport monitorues për zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe kufizimet që dalin nga kriza e Kovid-19", Instituti për të drejtat e njeriut, fq.14, <https://www.ihr.org.mk/mk/novosti/prv-monitoring-izveshtaj-za-prime-na-na-pristapot-zasnovan-na-chovekovi-prava-i-restrikiite-shto-proizleguvaat-od-kovid-19-krizata>

⁵¹ Më shumë rreth kësaj: <https://mhc.org.mk/news/govor-na-omraza-za-vreme-na-pandemija-dominiraat-prijavite-po-osnov-na-etnichka-i-politichka-pripadnost/>

Strategjia për shëndet në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2030

Më 7.12.2021, me propozim të Ministrisë së shëndetësisë, Qeveria miratoi Strategjinë për shëndet të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2030⁵², me Plan veprimi. Hartimi i saj ka marrë parasysh axhendën e BE-së për sisteme shëndetësore efektive, efikase dhe të disponueshme. Mes tjerash, identifikon tri çështje kryesore: 1. Mbështetje për forcimin e efikasitetit sistemeve shëndetësore; 2. Rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor, me fokus mbi fuqinë punëtore shëndetësore, dhe 3. Përmirësimi i sistemeve shëndetësore dhe roli i e-shëndetit, si dhe vlerësimi i teknologjisë shëndetësore dhe sistemeve të informacionit shëndetësor. Megjithatë, në Strategji nuk përmendet asnjë drejtim në lidhje me investimet dhe ndërtimit të sistemit shëndetësor që do të jetë në gjendje t'iu japë një përgjigje strategjike sfidave reale të së ardhmes, siç është një pandemi e re e mundshme⁵³. Kjo është veçanërisht shqetësuese, duke pasur parasysh faktin se, sipas OBSH-së, *kapaciteti i vendit për t'iu përgjigjur urgjencave të shëndetit publik para pandemisë KOVID-19*⁵⁴ *vlerësohej si i ulët*. Nisur nga kjo, fokusi aktual në marrjet e vendimeve ad hoc ndaj pandemisë Kovid-19 nuk duhet ta shpërqendrojë vendin nga të menduarit për kërcënimin e mundshëm të sëmundjeve të tjera infektive.

2.5.

Arsimi

Si rezultat i pandemisë procesi arsimor në RMV ka përjetuar ndryshime shumë të mëdha. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ai u zhvillua në përputhje me dekretet me fuqi ligjore për zbatimin e ligjeve për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe dekretet për ndryshimet e tyre. Në bazë të këtyre dekreteve, Qeveria, më 10.03.2020, me vendim ndaloi procesin edukativo-arsimor në të gjitha kopshtet, qendrat e zhvillimit të hershëm, qendrat ditore, shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shtetërore shkencore, si pasojë e të cilës mësimi organizohej përmes mësimin në distancë, gjegjësisht mësimin nga shtëpia, duke përdorur mjete të komunikimit elektronik. Mjetet e komunikimit elektronik ishin platformat e videokonferencave, posta elektronike apo sistemet e tjera të shkëmbimit të të dhënave elektronike, të cilat pa praninë fizike të studentëve, duhej të siguronin komunikim të dyanshëm. Si-

52 Strategjia shëndetësore e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2030, Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë, në dispozicion në <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2021/12/19.11.-SZ-posled-na-Konechna-Natsrt-Strategjia-MKD.pdf>

53 Më shumë mbi temën "Pandemitë e së ardhmes janë të pashmangshme, por ne mund ta zvogëlojmë rrezikun" nga Jonathan Smith, <https://ec.europa.eu/research-and-innovation/en/horizon-magazine/qa-future-pandemics-are-inevitable-we-can-reduce-risk>

54 Supra note 30, fq.7

pas të dhënave të grupit të fokusit, disavantazhi më i madh i këtij procesi të mirë organizuar arsimor ishte fakti se mbajtja e mësimit me anë të të mësuarit nga shtëpia, nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike, bënte që jo çdo fëmijë të kishte akses të barabartë në arsim cilësor, ngaqë **nxënësit nga familjet më të varfra** nuk kishin mjete të mjaftueshme për të siguruar pajisje që të mund të ndjekin mësimin pa pengesa, si dhe për faktin se për një lloj mësimi të këtillë nevojitet një lidhje stabile e internetit. Në këtë konkluzion del edhe MYLA (Macedonian Young Lawyers Association), e cila gjatë gjysmës së dytë të vitit shkollor 2020/2021 ka regjistruar raste në të cilat fëmijët nuk mund të ndiqnin mësimet online për shkak se familja kishte vetëm një aparat⁵⁵. Në këtë kontekst, janë prekur veçanërisht **fëmijët romë**, sepse 3% e familjeve romë nuk kanë akses në energji elektrike, 38% nuk kanë akses në internet dhe 51% nuk kanë kompjuter⁵⁶. Një sfidë shtesë për këtë grup të margjinalizuar është fakti se hendeku i shkrim-leximit ndërmjet romëve dhe komuniteteve të tjera etnike është i madh⁵⁷, kështu që të mësuarit nga shtëpia ishte një sfidë shtesë, pasi varej nga prindërit që t'i ndihmonin fëmijët e tyre me detyrat e shtëpisë. Masat e marra në këtë mënyrë ishin të papërshtatshme edhe për **fëmijët me aftësi të kufizuara**. Përveç kësaj, hulumtimi i IDNj-së, i cili bazohet në shqyrtimin e mendimeve të studentëve dhe mësuesve, tregon nevojën për krijimin e platformave të përshtatshme në të cilat do të jetë i disponueshëm i gjithë materiali, që do t'u përshtatet nevojave të mësimit në distancë, si dhe për zhvillimin e trajnimeve për personelin arsimor, për të siguruar arsimim cilësor⁵⁸.

2.6.

Masat ekonomike për rimëkëmbje

Kovid-19 solli sfida të mëdha edhe në sektorin ekonomik dhe tregun e punës. Veç kësaj, sektorët që kanë qenë dhe janë me rrezikun më të lartë ekonomik janë turizmi, hoteleria dhe shërbimet e hotelierisë, si dhe sektori i të vetëpunësuarve, pronarët e bizneseve të vogla dhe të mesme dhe sektori i prodhimit. Për t'iu përgjigjur pasojave negative, Qeveria miratoi një paketë të gjerë masash ekonomike/antikrizë⁵⁹, të cilat synonin të ofrojnë një stimul plotësues dhe të rëndësishëm ekonomik për qytetarët, bizneset dhe sistemin shëndetësor në vend.

55 Supra note 45, fq.17

56 Vlerësimi tematik i mbështetjes së BE-së për komunitetet romë dhe harta sociale e romëve, Raport mbi hartën sociale, AECOM International Development Europe SL, fq.18 dhe 59, Raporti i hartës sociale final_Macedonian.pdf (mtsp.gov.mk)

57 "E drejta për arsimim e fëmijëve romë me fokus të veçantë të vajzat romë" (2016), Instituti për të Drejtat e Njeriut, në dispozicion në <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications/obrazovanie.pdf>

58 Rezultatet e hulumtimit, rekomandimet dhe konkluzionet e plota mund t'i lexoni në "Arsimi gjatë pandemisë", Tamara Donevska, Instituti për të Drejtat e Njeriut, <https://bit.ly/3t8WYGN>

59 Lista e plotë e masave ekonomike gjendet në linkun e mëposhtëm: <https://vlada.mk/ekonomski-merki-covid19>

Paqeta e parë dhe e dytë synonin të ofrojnë mbështetje të përhershme për ekonominë dhe sektorin e shëndetësisë dhe përfshinin disa lloje ndihme, ndër të cilat më kryesoret në këtë kuadër janë asistenca dhe mbështetja për kompanitë për pagesën e pagave apo kontributeve për punonjësit, asistenca direkte financiare e personave që kanë mbetur pa punë dhe ndihma për personat që marrin ndihmë sociale etj. Paqeta e tretë kishte për qëllim nxitjen e rimëkëmbjes ekonomike dhe stimulimin e konsumit. Masa veçanërisht të rëndësishme nga kjo paqetë janë shpërndarja e kartelave për pagesë, të kredituara me 3.000 denarë për personat me pagë të ulët, ofrimi i mbështetjes për studentët deri në 6.000 denarë për mbulimin e shkollimit, si dhe masa e bonove për turizmin e brendshëm prej 6.000 denarë. Paqeta e katërt synonte ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë për sigurinë ekonomike dhe sociale të qytetarëve, si dhe nxitjen e konsumit privat. Nga kjo paqetë do të veçojmë shpërndarjen e kuponëve të pagesës për amvisëritë në nevojë, përfshirë të papunët, studentët dhe pensionistët, në vlerë deri në 6.000 denarë, pastaj kartën e pagesës shtëpiake për prindër të vetëm, pensionistë me të ardhura të ulëta, punëkërkues pasivë, si dhe masën e reduktimit dhe/ose heqjes së taksave parafiskale. Paqeta e pestë e masave ofroi mbështetje direkte financiare për kompanitë, për ruajtjen e vendeve të punës, mbështetje financiare për likuiditetin e sektorit privat, si dhe mbështetje për qytetarët. Në këtë grup masash, më e rëndësishmja është masa 'fshirja e interesit të qytetarëve në institucionet dhe ndërmarrjet publike'. Paqeta e gjashtë e masave synon të mbështesë aktivitetet që u mbyllën plotësisht, si dhe të përmirësojë likuiditetin e kompanive.

Veçanërisht të ekspozuar ndaj rënies së të ardhurave dhe varfërisë gjatë krizës së Kovid-19 ishin **punëtorë joformalë**⁶⁰, të cilët shpesh punojnë në sektorët që janë goditur më rëndë, si sektori tregtar, prodhimi, akomodimi dhe shërbimet ushqimore, zëjtaria, transporti dhe sektorët e lidhur me to, shërbimet personale etj. Edhe pse shteti kishte parashikuar disa masa, ku ata ishin përfitues direktë dhe indirektë, megjithatë disa kategori të cënueshme, si **punëtorët seksualë**, u përjashtuan nga sistemi i asistencës dhe mbështetjes së qeverisë dhe nuk ishin në gjendje t'i përdornin këto masa duke qenë se puna e tyre nuk pranohet ligjërisht. Për më tepër, perspektiva gjinore merret parasysh vetëm në mënyrë sporadike, ose vetëm në raste të jashtëzakonshme, p.sh. nga 46 masa të analizuara në lidhje me krizën Kovid-19, që mund të kenë një dimension gjinor, vetëm 14 mund të konsiderohen se janë pozitive gjinore, kurse 2 janë transformuese gjinore, që është vetëm 35% e të gjitha masave⁶¹. Kjo do të thotë se shumica e masave janë **neutrale gjinore** ose të shkruara në terminologji universale, e cila injoron situ-

60 Më shumë për këtë çështje në "Analizë e efektit të Kovid-19 tek punëtorët që janë pjesë e ekonomisë joformale dhe punëtorët e punësuar përkohësisht, përmes masave të propozuara për mbështetjen e tyre", Prof. Dr. Borçe Trenovski, M-r Tamara Mijovikj Spasova, M-r Bojana Mijovikj Hristovska, Prof. D-r Biljana Tashevska, M-r Kristijan Kozeski, Analitikë, <https://www.analyticamk.org/images/2021/studija-analiza-na-efektot-od-kovid-19.pdf>

61 Supra note 37 fq.37

atat specifike gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit midis grave dhe burrave, gjë e cila mbështet diskriminimin në bazë të seksit dhe gjinisë, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore mbi gratë⁶².

62 Përkufizimi marrë nga Instituti evropian për barazi gjinore, <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1192>,

PËRFUNDIME

Mbrojtja e të drejtave të njeriut është detyrë e çdo qeverie dhe respektimi i vazhdueshëm i të drejtave të njeriut është një çelës për të trajtuar me sukses krizën shëndetësore të shkaktuar nga Kovid-19. Masat, strategjitë dhe vendimet e miratuara nga Qeveria e RMV-së në përgjigje të krizës nuk i përmbanin plotësisht standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rekomandimet e organeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Masat dhe rekomandimet për mbrojtjen dhe parandalimin e Kovid-19, si dhe Masat ekonomike të Qeverisë për përballimin e krizës nuk bazoheshin në hartëzimin sistematik të nevojave të qytetarëve, veçanërisht atyre të cenueshëm dhe të marginalizuar dhe nuk i morën parasysh dhe nuk i adresuan nevojat e tyre specifike. Ato reflektonin nevojat e këtyre qytetarëve në baza ad hoc dhe vetëm nën presionin e publikut apo të organizatave të shoqërisë civile. Masat e marra kishin natyrë kryesisht reaktive dhe synonin mbrojtjen e sistemit shëndetësor nga kolapsi, pa ndikuar ndjeshëm në uljen e numrit të të infektuarve dhe të vdekurve si pasojë e koronavirusit. Veçanërisht negativ është fakti që Qeveria merrte masat pa u konsultuar me palët e interesuara, kurse pas reagimit të shoqatave, me vonesë arrinte t'i korrigjojë mangësitë. Kjo është arsyeja pse masat shpesh nuk korrespondonin me situatën epidemiologjike në vend dhe nuk parandaluan përhapjen e virusit.

Andaj, është mjaft e qartë pse një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut është mjete më i mirë për formulimin e masave aktuale dhe post Kovid-19 që e vendosin çdo individ në qendër të përgjigjes së tyre. QBDNj ofron udhëzime për veprim, ku barazia dhe dinjiteti janë vlerat më të larta. Udhëzon për veprime të synuara dhe të ndara që të adresohen më të cenuarit dhe kërkon që ata që janë veçanërisht të prekur ose të prekur rëndë të jenë në tryezën e vendimmarrjes. Për shembull, nëse QBDNj do të ishte përdorur sapo të shfaqej Kovid-19, masat parandaluese do të ishin vendosur mjaft herët, kategori të caktuara të njerëzve të cenueshëm nuk do të ishin "harruar", masat e veçanta për të lehtësuar dhunën në familje do të ishin zbatuar shpejt, ndërsa masat urgjente ekonomike do të kishin një ndikim më të gjerë. Nisur nga kjo, aplikimi sistematik i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut mund të shpëtojë jetë, të përmirësojë mirëqenien dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

REKOMANDIME

- Masat e marra nga shteti në përgjigje të një pandemie duhet të jenë të nevojshme, në përpjesëtim me rrezikun e vlerësuar dhe të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese, të kenë një fokus dhe kohëzgjatje specifike dhe të jenë në përputhje me detyrimet e shtetit sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, si dhe të njohin nevojën për të gjitha palët e interesuara.
- Çdo ndërhyrje në shëndetin publik, ekonomi dhe sektorët e tjerë të goditur nga kriza duhet t'u japë prioritet dhe mbështetje plotësuese (sociale, financiare dhe mjekësore) popullatës më të cenueshme, me qëllim kontroll më të mirë të pandemisë dhe sigurim i shëndetit dhe të drejtave të njeriut për ata që ndikohen më së tepërmi, gjegjësisht me anë të metodologjisë së krijimit dhe marrjes së vendimeve të përdorë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut.
- Me qëllim që të vetë vlerësojë përpjekjet dhe të nxjerrë mësim për krijimin e politikave më të mira, shteti, në të ardhmen duhet të bëjë vlerësim më të detajuar të ndikimit të çdo mase dhe politike nëpërmjet përdorimit të drejtpërdrejtë të mjetit të dizajnuar nga OKB - Listë për kontrollin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut⁶³
- Planet për rikuperim duhet të jenë të përgatitura nëpërmjet përcaktimit të saktë të nevojave për identifikimin e grupeve të cenueshme dhe t'u përgjigjen atyre. Veç kësaj, gjatë hartimit të këtyre planeve, duhen marrë parasysh vlerësimet e ndikimit të përgjigjes së deritanishme ndaj krizës mbi këta qytetarë, të përgatitur nga ana e organizatave ndërkombëtare dhe qytetare, si dhe nga mësimet e nxjerra.
- Gjatë krijimit të politikave të ardhshme, shteti duhet ta pranojë rolin e rëndësishëm të të gjitha palëve të përfshira të shoqërisë, duke inkuadruar dhe kategoritë e cenueshme të qytetarëve, organizatave qytetare, institucionet nacionale për të drejtat e njeriut, mediat etj, dhe me anë të kësaj të sigurohet përfshirja e tyre aktive dhe pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes.

⁶³ Checklist for a Human Rights-Based Approach to Socio-Economic Country Responses to COVID-19, April 2020, UNDP, <https://www.undp.org/publications/checklist-human-rights-based-approach-socio-economic-country-responses-covid-19>

